

BULETINI INFORMATIV



Gjatë muajit mars, ERE ka vijuar ushtrimin e veprimtarisë së saj rregullatore dhe vendimmarrëse në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror. Në këtë përmbledhje mujore do të gjeni informacion mbi licencimet e reja, publikimet, të dhënat e tregut, çmimet e shitjes së energjisë elektrike si dhe dokumentet/aktet rregullatore që ndodhen në proces konsultimi publik.

Synimi ynë mbetet garantimi i transparencës, rritja e eficiencës dhe mbështetja e zhvillimit të tregut të energjisë në vend.

Për më shumë detaje, vendimet dhe dokumentet e plota mund t'i shfletoni në faqen tonë zyrtare: www.ere.gov.al

Vendimmarrjet e Bordit të ERE gjatë muajit mars

Gjatë muajit mars 2026, Bordi i ERE ka zhvilluar 5 mbledhje vendimmarrëse për të cilat është bërë njoftimi të paktën 24 orë përpara edhe në rrjetet sociale të institucionit, duke ftuar të gjitha palët e interesit të ndjekin mbledhjet online. Në këto mbledhje u shqyrtuan dhe miratuan 22 vendime, që përfshijnë: fillimin e procedurave të reja të licensimit; licensime; autorizime; pezullim apo zgjatje të afateve vendimmarrëse; heqje licence si dhe miratime të pagesave rregullatore. Një përmbledhje e vendimarrjes së Bordit është publikuar pas çdo mbledhje në rrjetet sociale. Ndërsa vendimet e plota gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ERE-s në kategorinë [vendimet](#) si dhe në Fletoren Zyrtare.

LICENCIME

Procedura të filluara gjatë muajit mars 2026

Gjatë muajit mars, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) ka filluar procedurat për licencimin e shoqërive si vijon:

-“DION ENERGY” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga central fotovoltai, me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.

-“HYDROSOLAR ENERGY (HSE)” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga central fotovoltai, me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në Fshatin Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier.

-“GSA” shpk në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

-“Sunny Side Energy” shpk në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

Bordi i ERE-s, po ashtu, ka filluar procedurat për modifikimin e licencave në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për shoqërisë “NOVA SOLAR SYSTEM” shpk, “EZ-5 ENERGY” shpk dhe “EZ-5 ENERGY” shpk. Për këto vendime janë njoftuar shoqëritë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Mjedisit si dhe OST sha e OSSH sha, sipas rrjetit përkatës ku është lidhur centrali gjenerues i energjisë elektrike.

Gjithashtu, për aplikimet e mësipërme, në përputhje me “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ERE ka publikuar në median e shkruar, në faqen zyrtare www.ere.gov.al si dhe në rrjetet sociale Instagram, Facebook dhe LinkedIn, njoftimin për marrjen e objeksioneve para vendimmarrjes respektive të licencimit ose jo.

BULETINI INFORMATIV



Vendime ndryshim vendimmarrje

Gjatë muajit mars, Bordi i ERE-s ka vendosur të ndryshojë vendimin e Bordit të ERE-s nr. 302, datë 17.11.2025, mbi licencimin e shoqërisë “SPITALLA SOLAR” shpk, duke shfuqizuar pikën 2 të vendimit, pasi konstatoi se kjo shoqëri ka plotësuar kushtin e përcaktuar në këtë vendim duke depozituar Marrëveshjen për Lidhjen me Rrjetin e Transmetimit të parkut fotovoltaik Spitalla Solar, të nënshkruar me OST sh.a.

Vendime zgjatje vendimmarrje

Bordi i ERE-s ka vendosur të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “EZ-5 ENERGY” shpk, për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve fikse të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a.

Vendime mosmarrje në shqyrtim

Bordi i ERE-s ka vendosur të mos marrë në shqyrtim kërkesën e shoqërisë “EB ENERGY” shpk për marrjen e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të kapitalit si mjet për garantimin e detyrimeve ndaj “ProCredit Bank” sh.a, pasi rezultoi se marrëdhënia juridike me bankën është krijuar përpara se të merrej statusi i të licencuarit dhe të lindnin detyrimet përkatëse në kuadër të këtij statusi.

AUTORIZIME PËR GARANCI FINANCIARE

Gjatë muajit mars 2026, Bordi i ERE-s ka filluar procedurën për dhënien e autorizimit shoqërisë “Sunny Side Energy” shpk për transferimin e aseteve fikse të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Intesa SanPaolo Bank Albania” sh.a. Po ashtu, gjatë këtij muaji, Bordi i ERE-s ka miratuar kërkesat për marrje autorizimi si më poshtë vijon:

Transferim asetesh

Bordi i ERE-s, ka vendosur të jap autorizimin shoqërisë “NOVA SOLAR SYSTEM” shpk për transferimin të aseteve të paluajtshme të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a.

Vendosjen e kuotave si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve

Bordi i ERE-s ka vendosur të japë autorizimin për vendosjen e kuotave si mjet për garantuar shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve, për shoqëritë si vijon:

-“Sunny Side Energy” shpk, licencuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 13, datë 16.01.2025 në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për të garantuar shlyerjen e detyrimit ndaj palës kredidhënëse “Intesa SanPaolo Bank Albania” sh.a.

-“SA-GLE KOMPANI” shpk, licencuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 123, datë 29.08.2012 në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për të garantuar shlyerjen e detyrimit ndaj palës kredidhënëse “First Investment Bank-Albania” sh.a.

Për këto vendime janë njoftuar shoqëritë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

BULETINI INFORMATIV

Gjatë muajit mars Bordi i ERE-s ka miratuar gjithashtu Raportin Vjetor për vitin 2025 i cili është dorëzuar në Kuvend në përputhje me legjislacionin në fuqi brenda datës 31 mars dhe pritet të shqyrtohet në vijim.

GARANCITË E ORIGJINËS

Bordi i ERE-s ka vendosur të miratojë 4 (katër) kërkesa për krijimin e llogarive në regjistrin elektronik të garancive të origjinës dhe regjistrimin fillestar të pajisjeve të prodhimit për shoqëritë e licencuara në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, përkatësisht për shoqëritë “NOA ENERGY TRADE” shpk, “DEVOLL HYDROPOWER” shpk, “NOVA SOLAR SYSTEM” shpk dhe “ENER TRADE” shpk. Për këto vendime janë njoftuar shoqëritë.

REMIT

Në përputhje me “Rregulloren për integritetin dhe transparencën e tregut me shumicë të energjisë (REMIT)”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 126, datë 17.05.2021, si dhe Ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, gjatë periudhës Janar–Mars 2026, ERE ka vijuar me përditësimin e të dhënave mbi regjistrimin e pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike që kryejnë transaksione me shumicë në Shqipëri (regjistri REMIT). Për këtë periudhë 3-mujore, numri total i shoqërive të regjistruara në regjistrin është 94. Gjatë muajve Janar – Mars janë regjistruar gjithsej 7 subjekte: në Janar 2 subjekte (“Reytech Trading” sh.p.k. dhe “Energovia.Albania” sh.p.k.), në Shkurt 2 subjekte (“Trans Adriatic Pipeline AG Albania” sh.p.k. dhe “PARISOL” sh.p.k.) dhe në Mars 3 subjekte (“REBESOL” sh.p.k., “SAMASOL” sh.p.k. dhe “ZENINA” sh.p.k.). Regjistri është i publikuar dhe i përditësuar në faqen zyrtare të ERE-s: <https://remit.ere.gov.al/>

AKTIVITETET E ERE PËR KONSUMATORËT

Gjatë muajit mars, në Platformën e Krahasimit të Çmimeve (PCT), rezulton se janë të rregjistruar gjithsej 7 furnizues që ofrojnë furnizimin me energji elektrike për konsumatorët në treg të lirë, sipas nivelit të tensionit. Çmimet e energjisë elektrike:


- për konsumatorët e nivelit të tensionit **6 kV** variojnë nga **16.9 Lekë/kWh** deri në **18.34 Lekë/kWh**;
- për konsumatorët e nivelit të tensionit **10 kV** variojnë nga **15.8 Lekë/kWh** deri në **18.34 Lekë/kWh**;
- për konsumatorët e nivelit të tensionit **20 kV** variojnë nga **15.75 Lekë/kWh** deri në **18.34 Lekë/kWh**; dhe
- për konsumatorët e nivelit të tensionit **35 kV** variojnë nga **15.20 Lekë/kWh** deri në **15.90 Lekë/kWh**.

Me vendimin nr. 81, datë 12.03.2026, Bordi i EREs vendosi miratimin e disa ndryshimeve në “Rregulloren për Cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së Rrjetit në Sistemin e Transmetimit të Energjisë”, miratuar me vendimin nr. 207/2017 dhe në Treguesit e Kriteve Standarde të Cilësisë së Shërbimit në Sistemin e Transmetimit të Energjisë Elektrike. Këto ndryshime janë ndërmarrë me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit, duke garantuar standarde më të larta efikasiteti dhe sigurie në furnizimin me energji elektrike.

Ftojme të gjithë të interesuarit të vizitojnë faqen tonë zyrtare për të shfletuar të gjitha vendimet, raportet, çmimet dhe publikimet më të fundit: www.ere.gov.al

Na ndiqni në rrjetet tona sociale për tu azhurnuar në kohë reale

BULETINI INFORMATIV



TREGU I ENERGJISË

Kapacitetit total prodhues të energjisë elektrike të instaluar në vendin tonë gjatë muajit shkurt i janë shtuar 2 centrale fotovoltaike të pozicionuar në zonën e Fierit, fshati Seman dhe Grykë me kapacitet total të instaluar prej 4 MW (2 MW secili prej tyre) të cilët operohen nga shoqëritë “ORHER” sh.p.k., dhe “RENEW” sh.p.k. Të dyja shoqëritë zotërojnë kontrata shitblerje energjie me “FTL” sh.a. me çmim të rregulluar.

Muaji shkurt ka vijuar të përmirësojë ndjeshëm kapacitetin prodhues të Kaskadës së Drinit. Prodhimi neto i realizuar nga HEC-et e Kaskadës së Drinit për këtë muaj është 557,726 MWh ose rreth 36% më shumë energji elektrike e prodhuar se muaji shkurt i vitit të kaluar. Niveli i liqenit të Fierzës në fillimi muaji arriti kuotën prej 292.69 mmnd ndërsa fundi i muajit u mbyll në nivelin 293.42 mmnd. Sikurse evidentuar përgjatë këtij muaji kemi rritje të nivelit të ujit në liqenin e Fierzës prej rreth 0.75 metër.

Për shkak të prurjeve të mëdha shoqëria publike “KESH” sh.a. ka shkarkuar nga portat e HEC-eve rreth 870 milion m³ ujë si dhe ka realizuar shitje të energjise elektrike në tregun e pa rregulluar në sasinë 223,894 MWh me një çmim mesatar prej 50 Euro/MWh duke gjeneruar rreth 13 milion euro të ardhura.

Prodhimi total neto vendas për muajin shkurt u përlogarit 1,298,632 MWh ose rreth 75% më shumë energji elektrike e prodhuar se periudha korresponduese e vitit të kaluar ku kontribuesit kryesorë kanë qenë centralet hidrike me 96% dhe pjesa tjetër nga centrale fotovoltaike.

Balanca neto e shkëmbimit të energjisë elektrike për muajin shkurt rezultoi 518,234 MWh (dalje), si diferencë e eksportit të realizuar në sasinë prej 545,788 MWh dhe importit të realizuar në vlerën 27,554 GWh.

Humbjet e përgjithshme të sistemit të shpërndarjes së energjise elektrike për këtë muaj arrijnë në 15.39%, ndërsa ato të sistemit të transmetimit në vlerën 1.90 %.

Në të gjitha tregjet e ALPEX-it gjatë muajit shkurt u tregtuan gjithsej 204,691.64 MWh energji elektrike, ndërsa rrjedha ndërkufitare arriti në 56,652.59 MWh. Në Tregun e Ditës në Avancë u tregtua një volum total prej 197,439.91 MWh energji elektrike, me një çmim klerues mesatar prej 60.02 €/MWh ndërsa në Tregun e Ankandëve Brenda të Njëjtës Ditë u tregtua gjithsej 7,251.73 MWh me një çmim mesatar ditor klerues prej 62.06 €/MWh. Numri i Anëtarëve të Bursës ishte 41, të cilët morën pjesë në Tregun e Ditës në Avancë, ndërsa 28 prej tyre edhe në Tregun e Ankandëve Brenda të Njëjtës Ditë. Numri i Anëtarëve të Përgjithshëm të Klerimit arriti në 6.

BULETINI INFORMATIV



ÇMIMI I SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT

Në mbledhjen e datës 10.03.2026 Bordi i ERE-s miratoi çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin shkurt 2026, në vlerën 9.56 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

Ky çmim rezulton më i ulët krahasuar me muajin janar 2026, i cili ishte 13.04 lekë/kWh.

Çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF) është variabël dhe ndryshon nga muaji në muaj, si pasojë e ndryshimeve në koston e blerjes së energjisë në tregun e lirë për furnizimin e klientëve që marrin shërbimin në kushtet e mundësisë së fundit. Në këtë çmim, kostot e rrjetit dhe kostot administrative mbeten të pandryshuara, ndërsa komponenti kryesor që ndikon në luhatjen është kosto e energjisë së blerë.

Për muajin shkurt 2026, kosto mesatare e blerjes së energjisë për mbulimin e kërkesës së klientëve të FMF-së ka rezultuar në vlerën 5.92 lekë/kWh, me një sasi të nominuar në bursën e energjisë prej 100.86 MWh. Ndërkohë, për muajin janar 2026, kosto përkatëse ka rezultuar 9.30 lekë/kWh, me një sasi të nominuar prej 235.63 MWh. Në terma krahasues, kosto e blerjes së energjisë për muajin shkurt 2026 është ulur rreth 36.3% në raport me muajin janar 2026, ndërsa sasia e energjisë së prokuruar për furnizimin e klientëve të lidhur në nivelin e tensionit 35kV është ulur rreth 57.2%.

Për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV, të cilët furnizohen në kushtet e mundësisë së fundit, çmimi i shitjes së energjisë elektrike mbetet i pandryshuar në nivelin 18.26 lekë/kWh, siç është miratuar nga ERE në muajin shkurt 2026. Ky çmim mbetet fiks, pasi energjia për këtë kategori sigurohet nga KESH sh.a. me një kosto të qëndrueshme furnizimi. Në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe për të garantuar transparencë ndaj palëve të interesuara, ERE miraton dhe publikon periodikisht çmimin e llogaritur të shitjes së energjisë elektrike nga FMF, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

PUBLIKIME DHE PËRDITËSIME NË WEBFAQE DHE NË RRJETET SOCIALE

Gjatë muajit mars është përditësuar informacioni në webin e ERE-s www.ere.gov.al dhe rrjetet sociale me [vendime](#), [njoftime të mbledhjeve](#), [njoftime mbi aplikime të reja për licencim](#) si dhe [çmimet e shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për vitin 2026](#).

Gjithashtu, në webfaqen e ERE-s gjenden të rifreskuar regjistrat e mëposhtëm:

- Kërkesa dhe përgjigje në Programin e Transparencës ([kliko këtu](#))
- Ankesa të konsumatorëve ([kliko këtu](#))
- Licencime ([kliko këtu](#))
- Autorizime ([kliko këtu](#))
- Procedurat e autorizimit në proces ([kliko këtu](#))
- Procedurat e licencimit në proces ([kliko këtu](#))